

Personat e shëndetit dhe sigurisë vizitojnë biznesin tim? – Pse?

(The health and safety people visit my business – Why?)

HSE (organizata e shëndetit dhe sigurisë) dhe autoritetet lokale ndajnë përgjegjësinë për të rregulluar shëndetin, sigurinë dhe mirëqënien e atyre që punojnë dhe të atyre që ndikohen nga aktiviteti i punës, duke përfshirë publikun. Ne duam që shëndeti dhe siguria (health and safety) të shihen si një gur i themellit i një shoqërie të civilizuar dhe kështu të arrijë një standart shëndeti dhe sigurie të vendit të punës që të jetë i pari në botë (tashmë ne kemi një nga standartet më të mira të sigurisë). Ne po punojmë për këtë në partneritet me bizneset, me punonjësit dhe sindikatat e tyre. Ne ofrojmë këshillë, udhëzime dhe informacion – si në shkallë kombëtare ashtu dhe në shkallë lokale.

Ne gjithashtu ndihmojmë për të arritur qëllimet tona duke vizituar bizneset individuale. Si vendosin HSE dhe autoritetet lokale se cilin biznes të vizitojnë? Ne e bëjmë këtë mbi bazën (kriterin) e rrezikut. Ne **e përqëndrojmë punën tonë atje ku rreziqet ka të ngjarë të jenë më të mëdha** dhe atje ku do të ketë ndikimin më të madh, veçanërisht atje ku:

- Ne kemi prova ku **performanca e shëndetit dhe sigurisë është e dobët** – ose në biznesin apo sektorin tuaj ose në qoftë se lloji i punës që ju bëni tregon një ritëm të lartë aksidendetesh apo sëmundjesh. Kur viziton biznesin tuaj stafi jonë do të përqëndrohet në rreziqet që identifikohen si prioritet për përmirësimet në shkallë kombëtare të sigurisë dhe shëndetit (për shembull rrëzimet nga lartësitë ose në nivel) sepse ato kanë potencialin më të madh për të përmirësuar performancën e shëndetit dhe sigurisë në shkallë kombëtare.
- **Ju operoni një nga një numër industrish të rrezikshme** (për shembull, industrinë detare, bërthamore, disa kimikate dhe eksplozive). Shumica e këtyre industrive operojnë në varësi të çështjes së sigurisë ose të rregjimit të licensimit. Kjo kërkon nga ne që të kryejmë një vlerësim të mëparshëm të një çështje sigurie që ju do të keni përgatitur duke parashtruar mënyrën se si i keni identifikuar dhe kontrolluar rreziqet në biznesin tuaj të cilat mund të rrezikojnë punëtorët tuaj dhe/ose pjestarë të publikut. Kur ne vizitojmë biznesin tuaj ne kërkojmë garanci që kontrollet e ndryshme si mekanike dhe organizative janë në vend dhe operohen në mënyre efektive brënda një kulture propocionale dhe pozitive të shëndetit dhe sigurisë.
- Ne duam **të investigojmë një incident specifik** (aksident ose një sëmundje të lidhur me punën) ose një ankesë. Këtu, ne i përqëndrojmë përpjekjet tona tek incidentet më të rënda – tek ato që çojnë në vdekje ose në plagosje të rënda – ose tek ato që kanë lidhje me prioritetet tona për përmirësimet e shëndetit dhe sigurisë në shkallë kombëtare. Investigimi i inspektorëve tanë do të kërkojë që të gjejë se çfarë ishte gabim dhe të nxjerrin mësimet si për biznesin tuaj dhe për të tjerët që bëjnë të njëjtën lloj pune.

HSE dhe stafi i autoritetit lokal do të **bëjnë gjithashtu dhe një numër të kufizuar vizitash** për të:

- Bërë një vlerësim të rreziqeve në bizneset ose ndërtesat e reja
- Piketuar disa sektorë apo zona gjeografike të caktuara dhe zakonisht për t'u përqëndruar në prioritetet të veçanta siç janë dhimbjet e shpinës dhe transporti për në punë.
- Bërë kontrole spontane të çastit për parë se si zbatohen rregullat.
- Për të qëndruar në korrent me proceset dhe zhvillimet e reja ose për qëllime trajnimi.

Për ndërmarrje që janë të vendosura në shumë kantjere (ndërtesa), ne kemi për qëllim të përqëndrohemi në të gjithë biznesin, se sa në ndërtesa individuale, dhe se si arrini standarte të qëndrueshme – për të shmangur dublikimin dhe përsëritjen. Ndërsa autoritetet lokale i përqëndrojnë përpjekjet e tyre në prioritetet që është rënë dakord në shkallë kombëtare dhe në reagimet ndaj aksidenteve dhe ankesave, ata mund të fokusohen gjithashtu dhe në çështje që kanë prioritet të veçantë për komunitetet lokale.

Çfarë do që të jetë arsyeja e vizitës, ne do të **kontrollojmë standartet e shëndetit, sigurisë dhe mirëqënies** në biznesin tuaj dhe **do t'ju japim ju këshillë** se si të parandalojmë sëmurjen ose plagosjen e njerëzve në punë.

Ne nuk besojmë se të gjitha rreziqet në punë mund të eliminohen. Në vend të kësaj, ne do të donim që të shikojmë se si ju po merrni masa të arsyeshme për të ulur rreziqet që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë. Ku të jetë e nevojshme, për shembull atje ku **kushtet e punës janë të dobëta ose ka një shpërfillje flagrante ndaj ligjit**, stafi jonë mund të përdorë fuqitë e tij për të kërkuar përmirësime, duke përfshirë dhe proçedime penale ku është e duhur.

Ne shpresojmë se ky shpjegim se përse vizitojmë bizneset, si i caktojmë prioritetet dhe çfarë bëjmë kur ndodhemi në biznesin tuaj, të jetë i dobishëm për ju. Në qoftë se dëshironi të na jepni mendimin tuaj në se ky shpjegim është i dobishëm dhe i qartë për ju, ju lutem na i dërgoni komentet tuaja tek adresa e e-mailit business.involvement.team@hse.gsi.gov.uk.